

# **HANDIKËS - MITROVICA**

**Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës**

## **Raport përfundimtar**

i projektit

**“Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të tyre”**

**Mitrovicë**

**Dhjetor 2017**

Raport Përfundimtar I Projektit “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të tyre”

Botues: Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica

Drejtoresha e raportit: Myrvete Hasani

Udhëheqës i raportit: Migjen Abrashi

Asistentët e raportit: Merita Abrashi dhe Skender Demi

© 2017 Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica

Të gjitha të drejtat e rezervuara

[handikos\\_mitrovica@hotmail.com](mailto:handikos_mitrovica@hotmail.com)

Ky hulumtim është mundësuar me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID. Përmajtja është përgjegjësi e Handikos Mitrovica dhe nuk pasqyron pikëpamjet e ATRC, USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Projekti “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore” implementohet nga Handikos Mitrovica, përkrahur nga Programi Angazhimi për Barazi – E4E, financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe zbatuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.



Raport Përfundimtar I Projektit “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të tyre”

## **PËRMBAJTJA**

Falënderim .....	4
Metodologjia.....	5
Hyrje.....	7
Qëndrimet e personave me aftësi të kufizuar, familjarëve të ture dhe akterëve relevant nga institucionet publike, private dhe civile në lidhjen me gjendjen e pronave të PAK-ut, perceptimet dhe sfidat:.....	13
Ndikimi i projektit “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të tyre” tek personat me aftësi të kufizuar .....	17
Rekomandimet.....	20

## Falenderim

Regjioni i Mitrovicës është regjioni me numrin më të madh të pa punëve dhe me probleme sociale dhe politike. Handikos Mitrovica ka afërsisht 600 anëtarë me aftësi të kufizuar të moshave të ndryshme prej fëmijëve e deri tek të rriturit dhe të moshuarit.

Shumë njerëz në Kosovë nuk marrin mundin dhe të formalizojnë të drejtat e tyre mbi pronën e paluajtshme. Si rrjedhojë, ekziston një problem i përgjithshëm sa i përket mungesës së vullnetit për t'u angazhuar në proceset ligjore lidhur me bartjen dhe të drejtën e pronës. Në rastet kur proceset ligjore janë përdorur, çështjet dominuese në drejtim të zbatimit të ligjit kanë të bëjnë me ligjin e trashëgimisë dhe përdorimin e klauzolës për heqjen dorë. Gratë me aftësi të kufizuar shpesh heqin dorë nga pronat e tyre të trashëguara në favor të vëllezërve dhe xhaxhallarëve për arsye kulturore dhe duke e respektuar të drejtën zakonore shqiptare. Përderisa nuk ka statistika zyrtare mbi heqjen dorë, dhe shumë gra me aftësi të kufizuar vullnetarisht heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore. Një aspekt tjetër problematik i ligjit të trashëgimisë në këtë kontekst shoqëror është aftësia e trashëgimtarëve të heqin dorë nga të drejtat pasurore të fëmijëve të mitur pa asnjë mbikëqyrje të jashtme pa marrë parasysh nëse interesat më të mira të fëmijës janë marrë në konsideratë.

Handikos Mitrovica gjatë vitit 2017 ka implementuar projektin “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të tyre” në Mitrovicë, me qëllim avokimin dhe promovimin e të drejtave pronësore në mesin e Personave me Aftësi të Kufizuar, pa dallim gjinie, në Komunën e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skenderajit. Andaj, dëshiroj të shpreh mirënjohje dhe falenderim për të gjithë intervistuesit dhe pjesëmarrësit në takimet dhe aktivitetet tona, të cilët kanë qenë të gatshëm ta ndajnë kohën e tyre dhe të marrin pjesë në raportin tonë. Falenderoj udhëheqësin e hulumtimit Migjen Abrashi, si dhe anëtarët e stafit të Handikos Mitrovica, kontributi i të cilëve ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm për realizimin e raportit përfundimtar.

*Myrvete Hasani*

*Drejtoreshë Ekzekutive e OJQ-së Handikos Mitrovica*

## **LISTA E SHKURTESAVE**

OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
PAK	Person me Aftësi të Kufizuar

## Metodologjia

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar të Mitrovicës – Handikos Mitrovica ka shfrytëzuar informatat e mbledhura për ta hartuar metodologjinë e raportit përfundimtar me qëllim të njohjes së gjendjes reale të drejtave në pronë të personave me aftësi të kufizuar në Komunën e Mitrovicës.

**Raporti përfundimtar** është zhvilluar me anë të pyetësorëve, takimeve dhe intervistave me përfaqësuesit e Institucioneve Publike, Private dhe Civile më Komunën e Mitrovicës në periudhën Shtator-Tetor 2017.

Këtij raporti iu është bashkangjitur edhe një pjesë e përshkrimit të ndikimit të projektit “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të tyre” të implementuar nga Handikos Mitrovica dhe të përkrahur nga ATRC-USAID përmes programit Angazhimi për Barazi, tek Personat me Aftësi të Kufizuar në Mitrovicë. Projekti në fjalë i Handikos Mitrovica ka përmirësuar dukshëm gjendjen e personave me aftësi të kufizuar në Mitrovicë, posaqërisht përfituesëve direkt të projektit.

**Rekomandimet** janë finalizuar në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve dhe shoqërisë civile përgjatë takimeve të programit. Raporti është përfunduar në dhjetor 2017.

## Hyrje

Çdo person gëzon të drejtat universale të cilat janë të njohura me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat e garantuara për të gjithë personat me aftësi të kufizuara nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuar janë pjesë e natyrshme dhe integrale e shoqërisë si tërësi, të cilëve shteti duhet të ofroj garanci dhe mundësi që përmes formave të ndryshme, PAK të mund të kontribuojnë në zhvillimin e vendit tonë dhe në të njëjtën kohë të integrohen në proceset e ndryshme shoqërore, për përfshirjen dhe trajtimin e duhur të kësaj kategori pa asnjë lloj diskriminimi.

Korniza ligjore e cila merret me rregullimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, si në kuptimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, e po ashtu edhe të drejtës ndërkombëtare, është mjaftë e gjerë.

Në Kosovë të drejtat e barabarta të grave duke përfshi edhe personat me aftësi të kufizuar në përgjithësi, dhe në trashëgimi në veçanti, janë garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Trashëgiminë, Ligjin për Procedurën Jo kontestimore dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore. Megjithë ekzistencën e një kornize ligjore, tradita popullore e ndarjes së pasurisë që bazohet në të drejtën zakonore, siç është Kanuni i Lekë Dukagjinit apo rrallëherë dhe të së drejtës së trashëgimit sipas shariatit në të drejtën islame, ka marrë terrenin kryesor në ndarjen e trashëgimit mes trashëgimtarëve në Kosovë. Hapësira që krijon ligji duke mundësuar marrëveshjen e palëve dhe mundësinë e heqjes dorë nga trashëgimia, bëjnë që palët të “merren vesh” mes vete, sipas rregullave kanunore apo rregullave të tjera të ngjashme me traditat patriarkale në Kosovë.

Ligji i cili merret me gjininë dhe pronën në Kosovë është modern dhe i barazpeshuar. Problemet që ekzistojnë në ligj në lidhje me të drejtat pronësore të grave janë për shkak të 1) mospërputhjeve midis ligjeve ekzistuese; dhe 2) problemeve në praktikë, në

mënyrë të veçantë aplikimit diferencues të ligjit dhe strategjive burokratike që lejojnë përjashtimin e grave. Mospërputhjet më të rëndësishme në ligj që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore janë pretendimet e ndryshme për burimet që bashkëshortët kanë në martesat e regjistruara ligjërisht dhe në martesat “faktike” si dhe mungesa e qartësisë në lidhje me adresimin/vendin e duhur ligjor për rastet jo kontestimore të trashëgimisë. Gjithashtu, ekziston konfuzion nëse rastet e trashëgimisë jo kontestimore mund të shqyrtohen si nga ana e gjykatave ashtu edhe e noterëve.

Shumë njerëz në Kosovë nuk marrin mundin dhe të formalizojnë të drejtat e tyre mbi pronën e paluajtshme. Si rrjedhojë, ekziston një problem i përgjithshëm sa i përket mungesës së vullnetit për t'u angazhuar në proceset ligjore lidhur me bartjen dhe të drejtën e pronës. Në rastet kur proceset ligjore janë përdorur, çështjet dominuese në drejtim të zbatimit të ligjit kanë të bëjnë me ligjin e trashëgimisë dhe përdorimin e klauzolës për heqjen dorë. Gratë, personat me aftësi të kufizuar, shpesh heqin dorë nga pronat e tyre të trashëguara në favor të vëllezërve dhe xhaxhallarëve për arsye kulturore dhe duke e respektuar të drejtën zakonore shqiptare. Përderisa nuk ka statistika zyrtare mbi heqjen dorë, dhe shumë gra vullnetarisht heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore. Një aspekt tjetër problematik i ligjit të trashëgimisë në këtë kontekst shoqëror është aftësia e trashëgimtarëve të heqin dorë nga të drejtat pasurore të fëmijëve të mitur pa asnjë mbikëqyrje të jashtme pa marrë parasysh nëse interesat më të mira të fëmijës janë marrë në konsideratë.

Këto probleme ligjore janë përkeqësuar nga vështirësitë burokratike në nivelin komunal gjatë konstatimit të trashëgimtarëve ligjorë të një personi të vdekur. Procesi i trashëgimisë jep shumë mundësi për përjashtimin e trashëgimtarëve ligjorë pa dijeninë ose pëlqimin e tyre. Kjo shkakton probleme të veçanta për gratë, personat me aftësi të kufizuar, të cilat ka më shumë gjasa që të jenë të përjashtuara. Për më tepër, angazhimi i grave në ekonominë e Kosovës është jashtëzakonisht i ulët në krahasim me shtetet fqinje, që është disi befaluese duke pas parasysh që niveli arsimor i tyre është i ngjashëm me atë të meshkujve. Personat me Aftësi të Kufizuar përballen me nivele të larta të papunësisë dhe duke pasur parasysh nivelin e ulët të kapitalit të formalizuar në të cilin ato kanë qasje, mundësitë e tyre të vetë-punësimit janë të kufizuara.



## **Korniza Ligjore**

Shumica e ligjeve në lidhje me të drejtat pronësore dhe të trashëgimisë së grave në Kosovë janë relativisht të reja, që datojnë nga themelimi i shtetit, ku ligji i parë është botuar në vitin 2003. Para formimit të një shteti të pavarur, të drejtat pronësore dhe trashëgimore të grave janë qeverisur nga ligjet egalitare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Bonfiglioli, 2013). Në tërësi, ligji në Kosovë i plotëson normat ndërkombëtare për barazinë gjinore në sferat ekonomike dhe sociale. Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008, në nenin 7 (2) vë në dukje se “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke dhënë mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe fushat e tjera të jetës shoqërore.” Në pjesën vijuese, kuadri gjithëpërfshirës ligjor që i përket gjinisë në Kosovë do të analizohet dhe pasohet nga një diskutim të legjislacionit shtesë zbatues.

## **Ligjet e ndërlidhura me çështjet gjinore dhe pronësore**

Ligji për Pronën dhe të Drejtat Tjera Sendore i vitit 2009 përcakton kornizën për të gjitha të drejtat pronësore dhe transferimin e pronës në Kosovë për të gjithë qytetarët. Tre ligjet shtesë sigurojnë një kornizë për barazinë gjinore në Kosovë dhe për qasjen e grave në pronë: Ligji për Barazinë Gjinore, Ligji për trashëgimi, dhe Ligji mbi familjen. Këto tre ligje të gjitha u miratuan në vitin 2004. Ligjet e krijuara gjatë Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) janë moderne, egalitare, dhe qëllimisht në përputhje me kërkesat e BE-së. Ligji për Barazi Gjinore fillon me vendosjen e qëllimeve për shoqërinë. Ka një mbrojtje shprehimore të të drejtave pronësore të grave në ligj. Neni 12.1 nënvizon “Në legjislacionin ekonomik, financiar, të punësimit dhe mirëqenies sociale si dhe në programet makro dhe mikro - ekonomike, financiare, privatizim, përfshirë edhe të drejtën për trashëgimi dhe pronësi, kredi dhe burime natyrore duhet të mundësohet qasje e plotë dhe e barabartë për femra dhe meshkuj” (Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, 2004b). Nën këtë rubrikë të përgjithshëm të barazisë ekonomike, mbrojtjet e mëtejshme janë të specifikuar duke përfshirë pronësinë e përbashkët të pasurisë së fituar gjatë martesës. Ndryshimi i Ligjit për Barazinë Gjinore është duke u diskutuar në Kuvend së bashku me Projektligjin për Mbrojtjen kundër Diskriminimit i cili ndër karakteristikat tjera ndalon diskriminimin në

Raport Përfundimtar I Projektit “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të tyre”

bazë të gjinisë, identitetit gjinor, familjes, statusit martesor, dhe aftësisë së kufizuar (Projektligji për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, 2014).

Ka garanci të tjera të mos diskriminimit, tashmë të pranishme në ligj, dhe më e rëndësishmja, në kushtetutë. Neni 24 (2) i Kushtetutës së Kosovës thotë se “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose të ndonjë statusi tjetër personal.”

### **Prona në martesë dhe shkurorëzimi**

Neni 37 (2) i Kushtetutës thotë se “Martesa dhe shkurorëzimi rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve”. Ligji për familjen plotëson Kushtetutën dhe mbron të drejtat e grave për të hyrë vullnetarisht në martesë, për të vendosur me bashkëshortin e tyre se ku do ta kenë vendbanimin, të zotërojnë së bashku pronën e fituar gjatë martesës së tyre, dhe të ruajnë pronësinë e veçantë të pasurisë që sjellin në martesë. Grave po ashtu ju jepet e drejta për ndarjen e pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit (Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, 2004a). Ka disa zbrazëtira potenciale në Ligjin për Familjen në lidhje me statusin e martesave të cilat do të diskutohen në detaje më poshtë.

Martesat joformale ose të paregjistruara janë të zakonshme në Kosovë, prandaj është e rëndësishme se si ato trajtohen në ligj. Nuk është e zakonshme për njerëzit që të jenë zyrtarisht të martuar dhe të kenë martesën e regjistruar në komunë. Njerëzit shpesh kanë një martesë familjare dhe e konsiderojnë veten të jenë të martuar pa formalizimin juridik ose regjistrimin e martesës. Neni 14 i Ligjit për Familjen përcakton martesën si “një komunitet të regjistruar ligjërisht të dy personave të gjinive të ndryshme, përmes të cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes”. Sipas ligjit, personat pa martesë të regjistruara konsiderohen të martuar (në atë që është përmendur si një “bashkësi faktike” ose “jashtëmartesore”) në qoftë se ata: 1. kanë të drejtë të martohen, por nuk kanë lidhur një martesë ligjore, dhe 2. kanë bashkëjetuar haptazi si çift”. Ky përkufizim paraqet një sërë problemesh të cilat do të detajohen më poshtë. Problemi i parë është pragu i ulët për njohjen dhe i dyti është mospërputhja me ligjin e trashëgimisë, i cili vendos standardet më të larta për njohjen e një bashkëshorti në bashkësi faktike.

Raport Përfundimtar I Projektit “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësisë rreth të drejtave pronësore të tyre”

Përderisa nuk ka ndryshim në drejtim se kur marrëdhëniet faktike njihen si martesë në vendet e tjera evropiane, standardi i Kosovës është shumë i ulët. Disa vende evropiane kërkojnë tre vjet bashkëjetesë para njohjes (Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci), të tjerët kërkojnë regjistrimin e bashkëjetesës (Bullgaria, Republika Çeke), ose nuk e njohin bashkëjetesën si ligjërish të ngjashme me martesën (Itali, Letoni, Moldavi) (Këshilli i Evropës, 2009). Ka gjithashtu disa mospërputhje pasi që Neni 90 i Ligjit për Familjen flet për të drejtat pronësore që rrjedhin tek bashkëshortët nga një “martesë e regjistruar ligjërish.” Ndërsa në klauzolat e tjera, ligji është i qartë për atë se marrëdhëniet pronësore midis bashkëshortëve në bashkësi faktike duhet të jetë njëjta me ato në një martesë të regjistruar ligjërish.

### **Prona e trashëguar**

Siç është e dukshme, një nga ligjet më përkatëse në lidhje me pronësinë mbi pronën e grave në Kosovë është Ligji për trashëgimi. Ligji është egalitar, duke përcaktuar bashkëshortët dhe fëmijët si pjesë përbërëse të “rendit” të parë të trashëgimtarëve të detyrueshëm kur një person vdes pa lënë testament.<sup>1</sup> Pasi që përpilimi i testamentit nuk është një praktikë e zakonshme në Kosovë, përmbajtja dhe aplikimi i këtij ligji është veçanërisht e rëndësishme për të drejtat pronësore të grave. Bashkëshortët dhe fëmijët, si trashëgimtarë të domosdoshëm në rendin e parë të trashëgimtarëve, ndajnë pasurinë në mënyrë të barabartë (Ligji për trashëgiminë, nenet 12.1 dhe 12.2). Për shembull, në qoftë se një njeri vdes duke lënë bashkëshorten dhe tre fëmijët, bashkëshortja e tij do të trashëgojë një të katërtën e pasurisë dhe secili nga fëmijët e tij do të trashëgojnë një të katërtën e pasurisë.

Kjo kërkesë përfshin një proces të rëndë të vlerësimit të pronës së lënë nga i ndjeri për të përcaktuar pjesën e saktë të çdo fëmije dhe të bashkëshortes. Nëse pasuria e të ndjerit është e kufizuar - për shembull, vetëm shtëpia familjare - dëshira për vlerësimin dhe pastaj për ndarjen e pasurisë në katër pjesë të barabarta është e kufizuar dhe mund të krijojë një pengesë shtesë për proceset e mëposhtme të trashëgimisë formale. Nëse pasuria e të ndjerit kontestohet dhe rasti është dëgjuar në gjykatë, ose në qoftë se trashëgimtarët zgjedhin për të ndjekur ndarjen e pasurisë në gjykatë, atëherë gjykata mund të thirret në nenin 142 të Ligjit të trashëgimisë, i cili lejon një ndarje të ndryshme të pronës bazuar në pagesën e vlerës për disa trashëgimtarë.

Neni 142.1 i Ligjit për trashëgiminë parashikon që me kërkesën e trashëgimtarit, që ka bashkëjetuar ose ka punuar me trashëgimlënësin në të njëjtën bashkësi, gjykata mundet – nëse konstaton se ka baza të arsyeshme për kërkesë – të vendosë t’i caktojë atij një ose disa gjëra të luajtshme apo të paluajtshme, apo grupe të gjërave, që do t’i takojnë pjesës së trashëgimtarëve të tjerë, dhe se ai do t’i paguajë trashëgimtarëve të tjerë një sasi monetare të barabartë me vlerën e këtyre gjërave, brenda afateve kohore të përcaktuara nga gjykata duke marrë parasysh rrethanat e rastit. Kjo dispozitë do të lejojë që një shtëpi familjare apo një pasuri të mbetet në posedim të një trashëgimtari për sa kohë që vlera e pjesëve i paguhet trashëgimtarëve të tjerë.


### **Procedurat e zbatimit të trashëgimisë dhe bartjes së pronave**

Janë dy ligje që ndikojnë në zbatimin e ligjit në përgjithësi dhe Ligjit për trashëgiminë në veçanti. Këto dy ligje janë Ligji për Noterinë dhe Ligji mbi Procedurën Kontestimore (Ligji për Noterinë, 2008; Ligji mbi Procedurën Kontestimore, 2008). Në Kosovë, procedurat jo kontestimore të trashëgimisë mund të dëgjohen para noterëve në vend se në gjykata. Neni 29 i Ligjit për Noterinë, i cili identifikon funksionet noteriale, vëren se noterët mund: “Të merren me të gjitha procedurat jo kontestimore trashëgimore” (Ligji për Noterinë, 2008). Megjithatë, disa gjykata të shkallës së parë në Kosovë konsiderojnë rastet e trashëgimisë jo kontestimore (Dean, 2014). “Noterët latinë” janë hasur në një numër të sistemeve të drejtës civile në Amerikën Latine dhe në Evropë dhe kanë përgjegjësi për të hartuar kontratat dhe Vendimet e Trashëgimisë në rastet kur nuk ka mosmarrëveshje për të ndërmjetësuar (Ligji për Noterinë, 2008). Ata janë juristë të trajnuar dhe tarifatat e tyre janë të përcaktuara nga Ministria e Drejtësisë. Qëllimi i noterëve është që të kursehet koha e zyrtarëve të gjykatave dhe që rastet të kryhen shpejt nëpërmjet marrëveshjeve të formalizuara. Çfarë kjo do të thotë në aspektin e trashëgimisë është se shumë raste trajtohen nga noterët në vend se nga zyrtarët e gjykatës. Në rastet kur një familje vjen deri në një marrëveshje mbi ndarjen e pronës, ata të gjithë paraqiten para noterit me dokumentet e nevojshme. Kjo është ku gratë, ose dikush tjetër në familje, do të heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore. Noterët besohet të jenë më të shtrenjtë se gjykatat, por ata janë edhe më efikas.

## Qëndrimet e personave me aftësi të kufizuar, familjarëve të tyre dhe akterëve relevant nga institucionet publike, private dhe civile në lidhjen me gjendjen e pronave të PAK-ut, perceptimet dhe sfidat:

Nga 600 anëtarët, persona me aftësi të kufizuar, të Handikos Mitrovica, janë si vijon:

- 18.33 % prej tyre nuk kanë vijuar shkollimin fare;
- 32 % prej tyre kanë përfunduar shkollën fillore;
- 40 % prej tyre kanë përfunduar shkollën e mesme;
- 3% prej tyre kanë përfunduar fakultetin; si dhe
- 6.67 % prej tyre kanë përfunduar zanate/kurse të ndryshme.




Nga 40 persona me aftësi të kufizuar të intervistuar të dhënat janë si në vijim:

- Numri i femrave 17 (42.50 %);
- Numri mesatar i anëtarëve të familjes është 4;
- Numri i personave të martuar 19 (47.5 %);
- Numri i personave që janë pronar të pronave 11 (27.50 %), prej tyre femra 4 femra (10 %).

Të dhënat e punësimit të personave me aftësi të kufizuar në Sektorin Publik, Privat dhe Civil (janë marr të dhënat e të punësuarve në 10 Institucione Publike, 38 Institucioneve Private dhe 15 Civile), janë si vijon:


- Nga 3105 të punësuar në Sektorin Publik, Persona me aftësi të kufizuar janë vetëm 7, apo 0.23%;
- Nga 674 të punësuar në Sektorin Privat, Persona me aftësi të kufizuar janë vetëm 5, apo 0.74%;
- Nga 95 të punësuar në Sektorin Civil, Persona me aftësi të kufizuar janë 12, apo 12.63%.



Nga 40 familjar të personave me aftësi të kufizuar të dhënat janë si në vijim:

- Numri i familjarëve që I kanë të rregulluar qështjet e pronave tek fëmijët duke përfshi edhe personat me aftësi të kufizuar, 4 (10%);
- Numri I familjarëve që janë në gjendje të fillojnë ndarjen e pasurisë në mënyrë të barabartë, 27 (77.50 %);
- Numri I familjarëve që kanë konteste për të vazhduar me ndarjen e pasurisë tek fëmijët, 9 (22.50 %).

## Nga 40 familjar të personave me aftësi të kufizuar



Myrvete Hasani, Handikos Mitrovica, thekson “Femrat me aftësi të kufizuar janë dyfish të diskriminuara për të drejtat në pronë dhe trashëgimi, gjithashtu duke mos përjashtuar këtu edhe meshkujt me aftësi të kufizuar, Handikos Mitrovica ka punuar shumë, prej vitit 1995, deri tani kemi mundur që ti vetëdijësojmë dhe ti aftësojmë në të gjitha sferat e jetës.”

Hasime Tahiri Hasani, OJQ Mundësia, thekson “Si shoqëri duhet të veprojmë më shumë drejt përmirësimit të pzoziës së personave me aftësi të kufizuar, personat me aftësi të kufizuar janë të diskriminuar në përgjithësi, fatkeqësishtë flitet shumë pak për gratë me aftësi të kufizuar nga institucionet dhe nga shoqëria, kuadri politik dhe shoqëria nuk ka arritur të jep zgjedhje dhe të mos ketë më diskriminim ndaj PAK-ut, tani ka ardh koha që të përmirësohet jeta, pozicioni i tyre ne shoqëri dhe të gjitha të drejtat që itakojnë.”

Hajrullah Mustafa, sociolog, theksoj “Kjo temë ka nevojë për një analizë shumë dimensionale, nëse bazohemi në disa hulumtime, e drejta e personave me aftësi të kufizuar, është shumë sfiduese, shumë pak prej tyre kanë deklaruar që kanë të drejtë në pronë dhe trashëgimi, në media kemi pas shumë raste që janë sfiduar PAK-u për ti realizuar të drejtat e tyre”.

Arbër Berisha, zyra e Avokatit të Popullit – Mitrovicë, thekson “Institucioni Avokati i Popullit është i thirrur për ti mbrojtur të drejtat e njeriut, infrastruktura ligjore në Kosovë është komplet në harmoni me Bashkimin Evropian, por, sa është e zbatueshme në praktikë, ajo len shumë për të dëshiruar. Të drejtat për pronë dhe trashëgimi janë të garantuara me ligjet e Kosovës por edhe me konventa ndërkombëtare. Një pjesë e madhe e popullësisë funksionon ende me traditat, duke l dhënë përparësi të madhe vetëm meshkujve. Në proceset gjyqësore meshkujt l eliminojnë komplet femrat në trashëgimi. Një prej departamenteve nga Avokati l Popullit është edhe për personat me aftësi të kufizuar, zyret janë të hapura për palët gjatë ditëve të punës, ankesat nga personat me aftësi të kufizuar janë të pakta, ne jemi të gatshëm që edhe në zyret e Handikosit të vijmë për ti pranuar ankesa.”

Burhan Maxhuni, mbrojtës i viktimave në Prokurorinë e Shtetit, thekson “Jo vetëm shtetin tonë por edhe shtetet përreth sfidohen për të drejtat në pronë dhe trashëgimi. Ne si shoqëri duhet të vetëdijësohemi më shumë që vet prindi që e ka të drejtën absolute të realizoj ndarjen e pasurisë, andaj, rekomandoj që ligjeratat dhe fushatat vetëdijësuese dhe takimet të mbahen me prindërit”.

Florije Macula, prind i personit me aftësi të kufizuar, theksoj “Me ligj duhet të rregullohet që personit me aftësi të kufizuar ti takoj dy pjesë (dy hise), sepse personi me aftësi të kufizuar ka nevojë për mbikqyrës më vonë, edhe kjo kontribuon edhe më shumë që shoqëria të vetëdijësohet sepse personat me aftësi të kufizuar kanë të drejta të barabarta dhe kanë nevojë më shumë për përkujdesje sesa të tjerët.”



## **Ndikimi i projektit “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësitimit rreth të drejtave pronësore të tyre” tek personat me aftësi të kufizuar**

Projekti “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësitimit rreth të drejtave pronësore të tyre” propozuar nga Handikos Mitrovica është përkrahur nga Programi Angazhimi për Barazi - E4E me kohëzgjatje prej 7 muajsh (20 prill 2017 deri më 19 dhjetor 2017) me qëllim të zgjerimit pjesëmarrjes së Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK).

OJQ Handikos Mitrovica për ta realizuar qëllimin e projektit ka paraqitur dy objektiva specifike dhe rezultatet të cilat i konsideron si shumë të rëndësishme:



**Objektivi specifik # 1:** Persona me aftësi të kufizuar, nga Mitrovica, Vushtrri dhe Skenderaj, marrin njohuri mbi të drejtat e tyre të trashëgimisë dhe pronësore. Si dhe familjar të personave me aftësi të kufizuar (prindër, bashkëshort/e, vëllezër/motra) nga Mitrovica, Vushtrri dhe Skenderaj, marrin njohuri mbi të drejtat e trashëgimisë dhe pronësore, dhe ngrisin vetëdijën për përkrahje më të madhe të kësaj kategorije.



### **Rezultatet:**

- 200 anëtarë (120 vajza/gra dhe 80 djem/burra), persona me aftësi të kufizuar, nga Mitrovica, Vushtrri dhe Skenderaj, marrin njohuri mbi të drejtat e tyre të trashëgimisë dhe pronësore.
- 100 familjar të personave me aftësi

Raport Përfundimtar I Projektit “Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësitimit rreth të drejtave pronësore të tyre”

të kufizuar (prindër, bashkëshort/e, vëllezër/motra) nga Mitrovica, Vushtrri dhe Skenderaj, marrin njohuri mbi të drejtat e tyre të trashëgimisë dhe pronësore, dhe ngrisin vetëdijën për përkrahje më të madhe të kësaj kategorije.

- 10% të përfituesëve si raste individuale shqyrtohen dhe analizohen në sesionet individuale në mes ekspertit të fushës dhe personit me aftësi të kufizuar, pregaditen dokumentet e nevojshme për proceset e metutjshme për realizimin e të drejtës për trashëgimi dhe pronës.
- 200 broshura janë shtypur dhe shpërndarë.

**Objektivi specifik # 2:** Adresimi i rekomandimeve tek institucionet relevante për zgjerimin e PAK-ut pa dallim gjinie, për lirimin e pagesave të shërbimeve komunale (kadaster, gjykates) apo noterise për femra.

#### Rezultatet:



gjinie, në udhëzimet që lirohen gratë nga pagesat prej shërbimeve komunale (katastri, gjykata) apo noterët.

- Rekomandimet dhe të dalurat e projektit barten/transmetohen nga institucionet relevante lokale tek ato qendrore.

- Tryeza e rrumbullakët në Mitrovicë, ndikoj tek opinion për të diskutuar dhe dalur me rekomandime për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në trashëgimi dhe pronë.
- Avokimi për përfshirjen e kategorisë PAK (Personat me Aftësi të Kufizuar) pa dallim

- Përgjatë aktiviteteve do të synohet të del një trup/mekanizëm me përbërje të PAK-ut, Përfaqësuesëve të Institucioneve relevante për të drejtat e trashëgimisë dhe pronës si dhe përfaqësues tjerë të shoqërisë civile, të cilët do të llobojnë tutje për plotësimin e të drejtave të PAK-ut në bazë të konventave dhe ligjeve në fuqi.



Raport Përfundimtar I Projektit "Fuqizimi i Personave me Aftësi të Kufizuar përmes rritjes së vetëdijësimit rreth të drejtave pronësore të tyre"

## Rekomandimet

- Të kryhet një analizë mbi përshtatshmërinë e shtimit të barrierave procedurale ndaj të drejtës për heqjen dorë nga të drejtat në trashëgimi për PAK-un.
- Mbështetje ndryshimeve legjislative për të siguruar se çdo heqje dorë nga të drejtat në trashëgimi nga ana e grave, PAK, përfshin 1) pëlqimin vullnetar; 2) mundësinë për përfaqësim ligjor; 3) pasqyrim të plotë financiar; dhe 4) dokumentacion në gjuhë të thjeshtë rreth ndikimit financiar të heqjes dorë. Studimi krahasues lidhur me kohëzgjatjen e rasteve gjyqësore nga iniciimi deri në përfundim ndërlidhet me tre grupe specifike të rasteve: ato që adresojnë trashëgiminë në të cilat gratë kërkojnë të drejtat e tyre të plota, ato që adresojnë trashëgiminë në të cilat gratë heqin dorë nga drejtat e tyre ose nuk ka trashëgimtare femra, dhe ato që kanë të bëjnë me çështjet pronësore në përgjithësi.
- Monitorimi i gjykatave dhe përcjellja e rasteve kontestuese me qëllim që të identifikohen ku janë duke ndodhur vonesa dhe çfarë probleme ligjore paraqiten.
- Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike për PAK-un në procedurën trashëgimore dhe gjatë regjistrimit të pronës.
- Fushatë për ndërgjegjësimin publik të burrave në lidhje me përfitimet e përfshirjes së vajzave dhe grave në trashëgimi.
- Ofrimi i trajnimeve për zyrtarët komunal për çështje gjinore, noterët lokal, dhe zyrtarët e gjykatave në lidhje me ligjet e Kosovës dhe proceset e trashëgimisë.
- Pajisja e zyrtarëve komunal për çështje gjinore për të udhëhequr trajnime mbi të drejtat pronësore të gruas dhe çështjet e trashëgimisë në zonat rurale të Kosovës ku njohuritë në lidhje me ligjin duket të jenë më të kufizuara.
- Adresimi i çështjeve të ndarjes së informacionit në nivel të komunës që parandalon identifikimin e trashëgimtarëve femra.
- Angazhimi i organizatave të shoqërisë civile në aktivitetet edukuese rreth çështjeve të pëlqimit vullnetar dhe përfaqësimit ligjor.
- Rritja e ndërgjegjësimit përmes edukimit të publikut për burrat dhe grate (PAK), në lidhje me përfitimet e të drejtave pronësore të formalizuara dhe inkurajimi për transferimin zyrtar të pasurisë pas vdekjes.

- Zhvillimi i burimeve informuese, të tilla si pamflete dhe afishe, për të informuar publikun për proceset e regjistrimit të pronës.
- Inkurajimi i përpilimit të testamenteve përmes aktiviteteve të komunikimit për ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljes, të zbatuara nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) për të ndryshuar sjelljet dhe qëndrimet në lidhje me testamentin.
- Angazhimi i organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në aktivitetet edukative.
- Koordinimi i punëtorive nëpër komuna të ndryshme që ofrojnë trajnime për noterët lidhur me proceset e duhura ligjore për rastet e trashëgimisë.
- Hartimi i udhëzimeve të shkruara për noterët që merren me rastet e trashëgimisë.
- Avokimi për ndryshim legjislativ për të adresuar çdo zbrazëti dhe të arrihet përputhshmëria e Ligjit për trashëgiminë dhe Ligjit për familjen.
- Organizimi e një fushatë publike në terren për të inkurajuar martesat e regjistruara ligjërisht.
- Organizimi i një tryeze të rrumbullakët për këtë çështje me grupin (et) parlamentar të grave për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar ndryshimet ligjore për gratë dhe PAK-un.
- Angazhimi i PAK-ut, fermerë në fokus-grupe në lidhje me kontributin e tyre në bujqësi dhe ku ato mund të përfitojnë nga një rritje e formalizimit të pronës së tyre.
- Angazhimi i burrave në aktivitetet edukative për të nxitur të kuptuarit e tyre për përfitimet nga të drejtat e pronësisë të grave.
- Vlerësimi i sfidave specifike të regjistrimit të pronës në përgjithësi, dhe në mënyrë specifike për gratë në kontekstin rural në Kosovë, ku ka raportime dhe anekdota lidhur me frikën e fragmentimit të fermave dhe humbjen e tokës bujqësore.
- Angazhimi në veprimtari të marrëdhënive me publikun të cilat fokusohen në rolin e PAK-ut në familje fermere, si aktorë të rëndësishëm ekonomikë dhe vendimmarrëse, në vend të definimit si fuqi punëtore informale, dhe e papaguar.
- Krijimi i mundësive të gradeve të vogla për blerje të mjeteve për PAK-un të startojnë me biznese familjare, apo që i kanë ti fuqizojnë.